VENDIM
Nr.879, datë 22.12.2004

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA HAPJA E KANALIT KULLUES NË QYTETIN E DIVJAKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorimin e përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, (tokë arë), i cili preket nga hapja e kanalit kullues në qytetin e Divjakës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Divjakës.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 410 m^2 tokë arë, me 479 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë/m^2 tokë arë, të vlerësuar në shumën e përgjithshme 196 390 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë.
5. Fondi prej 371 890 (treqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Divjakës.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2004.
7. Afati për realizimin e punimeve të jetë 30 ditë nga dita e përfundimit të shpronësimit.
8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Divjakës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR HAPJEN E KANALIT KULLUES NË QYTETIN E DIVJAKËS

Nr.	Emri mbiemri	Sip.toke are $m/^2$	Njësia lekë $m/^2$	Vlera lekë
1.	Loni Uani Daka	410	479	196 390
	Totali			196 390